



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 20200640/8

Tiranë ___/___/2020

Lënda: *Rekomandim për zbatimin me korrektësi të kriterëve ligjore lidhur me shoqërimin e shtetasve në ambientet e Policisë së Shtetit, si dhe për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar.*

DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË SHTETIT
Drejtues Madhor Ardi Veliu
TIRANË

I nderuar Zoti Veliu,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit në datën 08.05.2019 ka bërë ankesë shtetësja S.M. Ankuesja shkruan se në datën 04.05.2019, së bashku me kumatën e saj dhe tre fëmijë minorene, nga të cilët dy të saj dhe një i kumatës, kanë udhëtuar me një taksi për të shkuar në Greqi. Kur kanë mbërritur në Pikën e Kalimit Kufitar (PKK) Kapshticë, rreth orës 23:00, punonjësi i policisë i ka komunikuar asaj se nga kontrolli në sistem rezultonte se ishte shpallur në kërkim nga Policia për falsifikim dokumentesh. Pas kësaj ajo është dërguar në Stacionin e Policisë Kufitare (SPK) Kapshticë ku është mbajtur deri në orën 12:45 të datës 05.05.2019, ndërsa kunata së bashku me tre fëmijët e tyre janë lënë të lirë. Ankuesja pretendon se refuzimi i saj për të dalë jashtë shtetit është bërë në mënyrë të kundërligjshme sepse ajo nuk ka asnjë pengesë ligjore për të dalë nga Republika e Shqipërisë. Gjithashtu ajo pretendon se gjatë kësaj kohe ka kërkuar avokat, por punonjësit e policisë nuk ia kanë siguruar atë. Ndërkohë u ka thënë se kishte bërë dy operacione në kokë dhe se ishte me mjekim, por ata nuk e kanë marrë këtë fakt në konsideratë.

Sipas saj, në orën 12:45 kanë ardhur punonjësit e Drejtorisë Vendore të Policisë (DVP) Tiranë të cilët pasi e kanë prangosur dhe e kanë shoqëruar me automjet në DVP Tiranë. Në këtë organ ka mbërritur rreth orës 16:00, është mbajtur 4 orë me pranga në duar dhe është pyetur nga disa persona të cilët nuk i janë prezantuar. Ajo pretendon se gjatë pyetjes prej tyre i është bërë presion psikologjik për të treguar se ku ndodhej bashkëshorti i saj, K. Ç. i cili ishte në kërkim. Gjithashtu ajo pretendon se i është bërë presion duke i thënë se do t'ja merrnin fëmijët minorenë dhe se do t'ja digjin dokumentet. Ndërkohë nuk i është lejuar që të njoftonte avokatin e kërkuar prej saj, z.A.V. Në këtë organ është mbajtur deri në orën 21:00.

Për shqyrtimin e kësaj ankese i kemi kërkuar shpjegime Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin (DVKM) Korçë dhe Drejtorisë Vendore të Policisë (DVP) Tiranë.

DVKM Korçë me shkresën nr. 840/1 prot., datë 15.08.2019 ndërmjet të tjerave na informoi se nga verifikimi i bërë në sistemin TIMS rezulton se shtetësja S.M. është paraqitur për të kryer procedurat e kontrollit kufitar në PKK Kapshticë në datën 04.05.2019, ora 23:54, por në momentin regjistrimit të saj sistemi ka gjeneruar alert "Person në kërkim" që nga data 19.04.2019 për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me shkresën nr. prot. extra 9074/K, "*Shtetësja S. M. shpallet në kërkim me kartelë "Rozë", pasi dyshohet se është autore e veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve", parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal. E ndjek Seksioni i Krimit Ekonomik e Financiar. Të ndalohet dhe të njoftohet DVP Tiranë*".

Nisur nga ky fakt, pasi janë bërë verifikimet e duhura me këtë "Alert", është njoftuar Salla Operative e DVKM Korçë dhe kjo e fundit ka njoftuar Sallën Operative të DVP Tiranë, e cila ka konfirmuar se një patrullë e shërbimeve të këtij organi do të nisej për ta marrë shtetasen S.M. për veprime të metejshme. Ndodhur në këto kushte është bërë shoqërimi i saj në ambientet e SPK Kapshticë.

Në vijim të përgjigjes së dërguar, DVKM Korçë na informoi se shtetasen S.M. i është refuzuar dalja nga Republika e Shqipërisë bazuar në Procedurën Standarde të Punës nr. 169, datë 28.02.2018 "Për refuzimin e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në kufi", kreu II, gërma "K", pika 4, ku parashikohet se:

"Personat që refuzohen në dalje, në kuptimin e pikës 4 të gërmës "K", konsiderohen personat për të cilët ka dyshime të bazuara se janë të implikuar në veprimtari kriminale të lidhura me terrorizmin dhe krimin e organizuar, për të cilët në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse të linjës, vendoset se largimi i tyre nga vendi, apo udhëtimi drejt një destinacioni të caktuar, do të dëmtojë sigurinë kombëtare ose hetimin e një veprë të rëndë penale".

Shtetësja S.M., në cilësinë e personit në kërkim është shoqëruar për llogari të autoritetit shtetëror kërkues, duke u bazuar në Procedurën Standarde nr. 938, datë 24.07.2019 "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë", kreu V, gërma "D", pika 4-4.1, "si person për të cilin ka dyshime të arsyeshme se ka kryer veprë penale."

Pasi është marrë konfirmimi nga salla Operative e DVP Tiranë, shtetësja S.M. duhet të mbahej dhe t'i dorëzohej shërbimeve të DVP Tiranë të cilët për efekt të largësisë kanë mbërritur në SPK Kapshticë në orën 12:30, orë në të cilën ajo u është dorëzuar kundrejt procesverbalit përkatës.

Lidhur me vonesën e mbajtjes së saj në SPK Kapshticë i është përcjellë shqetësimi Sallës Operative të DVP Tiranë, por kjo e fundit ka kërkuar që të prisnim deri në mbërritjen e shërbimeve të këtij organi. Pra, arsyeja e mbajtjes të shtetasës S.M. në gjendje shoqërimi për rreth 13 orë e 45 minuta në ambientet e SPK Kapshticë është me karakter objektiv, për shkak të mbërritjes me vonesë të shërbimeve të DVP Tiranë.

Shtetësja S.M. është informuar dhe sqaruar për arsyen e shoqërimit në ambientet e SPK Kapshticë dhe është treguar kujdes për respektimin e procedurave të shoqërimit. Përveç sa më sipër, në këtë përgjigje u informuam se nuk është provuar pretendimi i saj për t'u takuar me avokatin, sepse nëse do të kishte bërë një kërkesë të tillë, do t'i ishte mundësuar takimi me të.

Ndërsa DVP Tiranë me shkresën nr. 17105/1K prot., datë 20.08.2019 ndërmjet të tjerave na informoi se, në datën 05.05.2019 nga shërbimet e PKK Kapshticë është njoftuar në Sallën Operative të DVP Tiranë se ishte kapur shtetësja e shpallur në kërkim S.M. Në drejtim të PKK Kapshticë janë nisur shërbimet e policisë të DVP Tiranë duke qenë edhe një punonjëse policie femër konform rregullave të përcaktuara në nenin 109 të ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar dhe Urdhrin nr. 92, datë 06.02.2015 në të cilin parashikohen rregullat për shoqërimin e shtetasve dhe personave në kërkim. Është bërë shoqërimi i saj në ambientet e DVP Tiranë për të cilën është përpiluar edhe raporti i shoqërimit.

Menjëherë sapo është shoqëruar në ambientet e DVP Tiranë i është blerë dhe dhënë ujë e ushqim, ndërsa pas konsultimit me prokurorët e çështjes dhe në prani të psikologes është bërë intervistimi i saj në lidhje me ngjarjen e ndodhur në datën 09.04.2019. Gjatë intervistimit nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore janë zbatuar detyrimet ligjore që rrjedhin nga Kodi i Procedurës Penale dhe konkretisht neni 158 i cili parashikon përjashtimin nga detyrimi për të dëshmuar. Në ambientet e DVP Tiranë në asnjë moment nga ana e saj nuk është kërkuar prezenca e ndonjë avokati mbrojtës, si dhe nuk është mbajtur e prangosur gjatë intervistimit. Pas mbarimit të intervistimit kjo shtetase me vullnetin e saj të lirë ka nënshkruar deklarinë e saj, i cili i është dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.

Meqënëse DVP Tiranë nuk na dërgoi informacion për të gjitha pretendimet e ankueses, i kërkuam informacion shtesë dhe konkretisht lidhur me pyetjet e mëposhtme:

1. Përse është mbajtur e shoqëruar ankuesja për 22 orë duke llogaritur edhe kohën e mbajtjes në gjendje shoqërimi në SPK Kapshticë për rreth 13 ora e 45 minuta, kohën e shoqërimit të saj nga SPK Kapshticë në DVP Tiranë për rreth 3 orë e 15 minuta, si dhe kohën e mbajtjes në DVP Tiranë për rreth 5 orë!
2. Me çfarë cilësie është pyetur ajo?
3. Përse, sipas pretendimeve të ankueses, i është bërë presion psikologjik gjatë pyetjes nga punonjësit e policisë për të treguar se ku ndodhej bashkëshorti i saj K. Ç.?
4. Cilët janë emrat dhe detyrat e punonjësve të policisë që e kanë marrë në pyetje ankuesen?

Në përgjigje të kërkesës tonë, DVP Tiranë me shkresën nr. 23713 prot., datë 17.12.2019 na informoi se:

1. Nuk është në kompetencën e këtij organi vlerësimi i kohës së qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasës S.M. në PKK Kapshticë dhe koha e udhëtimit. Ndërsa në DVP Tiranë ajo është mbajtur deri në momentin që i është marrë deklarimi.

2. Shtetësja S.M. është pyetur duke zbatuar detyrimet ligjore që rrjedhin nga Kodi i Procedurës Penale dhe konkretisht neni 158 "Përjashtimi nga detyrimi për të dëshmuar".

3. Shtetases S.M. nuk i është bërë presion psikologjik në asnjë moment, pasi edhe deklarimi i saj është marrë në prani të psikologut.

4. Ndërsa lidhur me emrat dhe detyrat e punonjësve të policisë që e kanë marrë në pyetje atë, na informoi se çështja është në hetim dhe se mund t'i drejtohem organit të prokurorisë.

Në bazë të kërkesës tonë, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Tiranë, me shkresën nr. 2087/1 prot./K.B, datë 10.03/2020 na dërgoi procesverbalin “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”, konkretisht shtetësja S.M., i cili është mbajtur në datën 05.05.2019 nga Kol Malçi dhe Arben Dymishi me detyrë oficerë të policisë gjyqësore në Seksionin për Hetimin e Krimeve ndaj Pronës në DVP Tiranë. Nga përmbajtja e këtij procesverbali rezulton se shtetësja S.M. i ka bërë deklaratimet para oficerëve të policisë gjyqësore me vullnetin e saj të lirë dhe në praninë e psikologes Besmira Muçaj. Gjithashtu ajo e ka nënshkruar atë pa bërë asnjë shënim, vërejtje apo pretendime.

Ndërkohë konstatojmë se, si nga përgjigjet e dërguara nga DVP Tiranë ashtu edhe nga procesverbali “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”, ankuesja nuk është pyetur në lidhje me veprën penale për të cilën dyshohej se kishte kryer atë të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal, e cila ishte shkak ligjor për refuzimin e daljes së saj jashtë shtetit dhe shoqërimin në organet e policisë.

Nga përgjigjet e dërguara pranë institucionit tonë nga DVKM Korçë dhe DVP Tiranë të cilat i përshkruam më sipër, konstatojmë se informacioni i dhënë nuk është i plotë dhe i saktë. Të dy organet e mësipërme në vend që të kishin zbatuar detyrimet ligjore të parashikuara nga aktet normative respektive të cilave u referohen për rastin e shtetases S.M., janë munduar që të justifikojnë shkeljet e kryera, të paktën lidhur me kohën e mbajtjes së saj në gjendje shoqërimi tej afatit ligjor. Duket sikur këto dy organe, për të cilat ankuesja ka pretendime, përfaqësojnë institucione të ndryshme dhe jo struktura të të njëjtit institucion, Policisë së Shtetit të RSH. Gjithashtu ato nuk e trajtojnë rastin ashtu sikurse është në fakt, si një të vetëm, sepse kemi të bëjmë me një person, shoqërimi i së cilës është bërë për të njëjtin shkak ligjor, si “Person në kërkim” dhe se veprimi (shoqërimi i saj) është bërë nga strukturat e të njëjtit institucion, Policisë së Shtetit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së shtetases S.M. dhe të përgjigjeve të kthyera nga organet e Policisë së Shtetit, vlerësojmë se pavarësisht faktit të mos provimit të të gjitha pretendimeve të ngritura nga ankuesja, por mbajtja e saj në gjendje shoqërimi për rreth 22 orë, e cila është e provuar tashmë, përbën shkelje të dipozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe të Procedurës Standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 938, datë 24.07.2019.

Sjellim në vëmendje se në nenin 109, pika 2 dhe 3, të ligjit “Për Policinë e Shtetit” parashikohet se:

“2. Personi i shoqëruar nuk trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe, në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë”.

3. Personi i shoqëruar ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton për shkaqet e shoqërimit. Ai/ajo duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë me një person të besuar dhe avokatin”.

Në Procedurën Standarde: “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 938, datë 24.07.2019, pika VI “Përgjegjësitë e punonjësit të policisë në rastet e shoqërimit dhe zbatimi i afateve” parashikohet se:

“1. Punonjësi i policisë ka të drejte të aplikoje masën e shoqërimit dhe mbajtje në mjediset e policisë një person për aq kohë sa është e domosdoshme për identifikimin apo sqarimin e rrethanave në ngarkim të tij, por jo më shumë se 10 orë.

2. Afati 10 orësh është kufiri maksimal kohor i mbajtjes së një personi.

Në rast se verifikimet e nevojshme (identifikimi dhe sqarimi i rrethanave) përfundojnë në një kohë më të shkurtër se sa është afati maksimal, oficerit të policisë i paraqiten dy mundësi:

a. Të lirojë menjëherë të shoqëruarin;

b. Të kryej ndalimin/arrestimin e tij, në bazë të nenit 253/2 dhe nenit 251/3 të Kodit të Procedurës Penale”;

Në pikën VII të kësaj procedure “Zbatimi i të drejtave të njeriut dhe siguria për personin e shoqëruar” parashikohet se:

“Në të gjitha rastet e shoqërimeve, punonjësit e policisë janë të detyruar të njohin dhe zbatojnë të drejtat e personave të shoqëruar, si dhe japin siguri për jetën, shëndetin, kushtet e qëndrimit dhe trajtimit human në këto ambiente.

1. Të drejtat e personave të shoqëruar

Personat e shoqëruar kanë këto të drejta që jua njeh ligji:

a. Të trajtohet në mënyrë humane, njerëzore dhe dinjitoze pa diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, besimit, etnisë, bindjeve politike, fetare ose filozofike, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore.

b. Personi i shoqëruar nuk mund të mbahet përtej afatit kohor që nevojitet për sqarimin e pozitës dhe çështjes, në çdo rast zbatohen përcaktimet e pikës “VI” të kësaj procedure”.

Ne vlerësojmë se pavarësisht qëllimit të justifikuar të refuzimit të daljes jashtë territorit të RSH të ankueses, pasi ajo ka qenë person në kërkim si dhe marrjes së ndonjë informacioni të mundshëm prej saj lidhur me veprën penale të rëndë që ka kryer bashkëshorti, rasti në fjalë duhej të vlerësohej dhe trajtohej me përgjegjësi të plotë dhe në mënyrë korrekte si nga SPK Kapshticë, por edhe nga DVKM Korçë dhe DVP Tiranë. Prej këtyre strukturave duhej organizuar puna dhe marrë masat e nevojshme që veprimet me shtetasen e shpallur në kërkim të kryheshin brenda afatit ligjor. Menjëherë pas njoftimit të bërë nga PKK Kapshticë, DVKM Korçë dhe prej kësaj në DVP Tiranë, nga kjo e fundit duhej të ishin dërguar punonjësit e policisë të sektorit përkatës për të shkuar në SPK Kapshticë dhe kryer veprimet në vend me të kërkuarën. Pra, në këtë rast veprimet për refuzimin për të dalë jashtë vendit, mbajtjen në gjendje shoqërimi në pritje të dorëzimit të saj punonjësve të DVP Tiranë, marrja e saj në dorëzim prej këtyre të fundit dhe transportimi i saj në DVP Tiranë ku ajo është pyetur dhe i janë marrë deklaratimet, janë kryer nga strukturat e DVKM Korçë dhe DVP Tiranë. Sqarojmë se nga përgjigjet e dërguara në institucionin tonë nga DVKM Korçë dhe DVP Tiranë nuk është dhënë informacion lidhur me kohën, orën e njoftimit nga një strukturë në tjetrën për kapjen e personit në kërkim me qëllim për të identifikuar përgjegjësinë ligjore dhe organin përgjegjës.

Në përfundim, pavarësisht shkakut të pretenduar si justifikim për kalimin e afatit 10 orë të shoqërimit, rezulton se punonjësit e Policisë së Shtetit kanë shkelur ligjin duke mos liruar menjëherë shtetasen S.M., pas kalimit të këtij afati.

Edhe më problematike paraqitet situata e përgjigjes së Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, në të cilën shprehen se ky organ mban përgjegjësi për afatet e përlogaritura që nga momenti i marrjes së personit të shoqëruar në ngarkim të tyre, qëndrim i cili është jokorrekt dhe jo në përputhje aktet normative të sipërpërmendura, pasi Policia e Shtetit është strukturë unitare dhe e centralizuar.

Po ashtu, do të ishte me vend në përmbushje të standarteve më të mira të të drejtave të njeriut, që personave të shoqëruar në ambientet e organeve të policisë t'u komunikohet në formë shkresore karta e të drejtave, duke u shoqëruar dhe me nënshkrimet e personave përkatës si dhe orën e saktë të komunikimit.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit ligjor *në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; si dhe nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të nevojshme për respektimin e kriterëve ligjore të shoqërimit të shtetasve në organet e Policisë së Shtetit si dhe të të drejtave të personave të shoqëruar.
2. Marrjen e masave të nevojshme për analizimin e shkeljeve ligjore gjatë shoqërimit të shtetasve S.M. nga punonjësit e strukturave të SPK Kapshticë, DVKM Korçë dhe DVP Tiranë dhe nxjerrjen e përgjegjësisë ligjore ndaj personave përgjegjës.
3. Përgjithësimin e këtij rasti në strukturat e Policisë së Shtetit me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen të shkeljes së të drejtave të personave të shoqëruar në ambientet e policies si dhe përmirësimin e punës në përputhje me procedurat standarde për të parandaluar shkelje të tilla ligjore.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi dhe masat që do të merrni për zbatimin e tij, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, konform nenit 22 të ligjit *“Për Avokatin e Popullit”*.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi

Konceptoi: S. Nushi